

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Durimi / *es-Sabr*¹ / الصَّبْرُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Për sa i përket seksionit të mirësjelljes (قسم الأخلاق), kjo ka dhjetë kapituj: durimi, kënaqja, mirënjohja, modestia, vërtetësia, altruizmi, morali i mirë, përlësia, fisnikëria, dhe paqësimi

Allahu ﷻ thotë:

"وَاصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ"

“Ki durim (O Muhamed)! Dhe durimi yt nuk arrihet ndryshe veçse nëpërmjet Allahut.” (en-Nahl, 127)

Sabri apo durimi nënkupton ta shtrëngosh vetveten që t'i durojë vështirësitë dhe të mos ankolesh. Kjo është shkalla më e rëndë për besimtarët e rëndomtë, më e huaja në shtegun e dashurisë, dhe më e qortueshmja në shtegun e teuhidit². Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është përmbajtja nga gjynahu:

¹ Durimi është një nga kuptimet e sabrit, që po ashtu nënkupton këmbëngulësi dhe përmbajtje. Disa nga antonimet e durimit janë: paniku, shqetësimi, plogështia, zhgënjimi.

² Imam el-Harawi po përpiqet të vërë në pah një koncept të drejtë, që është që kënaqja (*rida*) të mbizotërojë në shtegun e dashurisë dhe shpërfillja e plotë e vetvetes të mbizotërojë në shtegun e teuhidit. Mirëpo, mund të argumentohet se konceptet si durimi, kënaqja dhe pikëllimi nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Si njerëz që jemi, është e natyrshme ta ndiejmë dhimbjen e humbjes. Më i miri i njerëzimit ﷻ tha: “Po na pikëllon largimi yt, o Ibrahim!” Dhe ai ﷻ u urdhërua nga Allahu të tregonte durim: “Ki durim (O Muhamed)! Dhe durimi yt nuk arrihet ndryshe veçse nëpërmjet Allahut” (Sad, 44). Durimi s’ka të bëjë vetëm me durimin e hirshëm në vështirësi, por ka të bëjë dhe me këmbëngulësinë në shtegun e drejtë, çka lyp një vendosmëri të madhe.

- Duke parë paralajmërimet, duke ruajtur imanin dhe duke iu shmangur pasojave të bërjes së haramit. Por, më së miri është të mos bësh gjynahe ngaqë të vjen turp³

Niveli i dytë është këmbëngulja në dëgjueshmëri:

- Duke adhuruar Allahun me përpikëri, duke ruajtur me devocion adhurimin që bën dhe duke e përmirësuar me dije⁴

Niveli i tretë është durimi nëpër sprova:

- Duke vërejtur shpërblimin e madh, duke pritur fundin e mirë dhe duke shpërfillur fatkeqësinë me anë të kujtimit të favoreve dhe mirësive të mëhershme.

Durimi më i dobët është durimi për Allahun, që është durimi që bëjnë besimtarët e rëndomtë. Mbi këtë është durimi nëpërmjet Allahut, që është durimi i të dalluarve nga besimtarët. Dhe më lart mbi këtë është durimi me Allahun, që është durimi i ndjekësve të shtegut të pastrimit shpirtëror.⁵

³ Të turpërohesh që të bësh gjynah duke e ditur se Zoti yt të sheh dhe të jesh plotësisht i vetëdijshëm se po tërheq pakënaqësinë e Tij. Kjo, me siguri, është më lart se shkalla e frikës, por nuk mohon frikën. Pra, turpi dhe frika nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Allahu lavdëroi pejgamberët e vet për shkakun se ia kishin frikën: “Ata ngarendnin për të bërë punë të mira dhe na luteshin me dëshirim e ankth, dhe ndaj Nesh qenë të përulur.” (el-Enbijaa, 90)

⁴ Që punët e mira të jenë të pranueshme, duhet t'i kushtohen vetëm Allahut dhe të jenë në përputhje me dijen (e Sunetit).

⁵ Të qenët i duruar për Allahun në pritje të shpërblimit të Tij. Të qenët i duruar nëpërmjet Allahut konsiderohet të jetë një nivel më i lartë nga Imam el-Harawi, sepse kjo ka të bëjë me gjendjen (*haal*) e atyre që mohuan të kenë çfarëdo ndikimi (*hawl*) apo fuqie (*kuwweh*). Të qenët i duruar me Allahun nënkupton t'i durosh me pranim (pëlqim) caktimet e Tij. Imam Ibn Kudaame argumentoi në *Medaarixh* se durimi për Allahun duke iu bindur urdhrave të Tij dhe duke u pajtuar me vullnetin e Tij duhet të jetë shkalla apo stacioni më i lartë. Besimtarët e plotë bëjnë këtë ndërsa mohojnë të kenë çfarëdo ndikimi (*hawl*) apo fuqie (*kuwweh*).